REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 107, Datë 24.12.2025

PËR

" MIRATIMIN E NUMRIT E PUNONJËSVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE NË VARTËSI, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË PËR VITIN 2026, BASHKIA HAS"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit **nr.139/2015** *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, ligjit **nr. 152/2013** *"Për Nëpunësin Civil"*, i ndryshuar, ligjit **nr.7961,** datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*, ligjit **nr.44/2015** *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, ligjit **nr.68/2017** *"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"*, ligjit **nr.9936,** datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, ligjit **nr.10296,** datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar.
Bazuar në VKM **nr.113** datë 01.03.2023, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*; **VKM nr.419,** datë 26.06.2024,*"Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"*; **VKM nr.425,** datë 26.06.2024,*"Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimorë dhe të institucioneve plotësuese të sistemit arsimorë parauniversitar"*; **VKM nr.503,** datë 01.08.2024 për disa ndryshime në **VKM nr.328,** datë 31.05.2023, *"Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"*; VKM **nr.625,** datë 28.9.2022, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM **nr.165,** datë 2.3.2016, *"Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"*, të ndryshuar; VKM **nr.421,** datë 26.6.2024**,** për disa shtesa dhe ndryshime në **VKM nr. 325,** datë 31.5.2023, *"Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit,*

Adresa: *Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,Tel/Fax.: +355 214 22080, e-mail:info@bashkiahas.gov.al*

funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, si dhe bazuar në përpilimin dhe hartimin e Projekt-Vendimit të Buxhetit të Bashkisë Has për vitin 2026,
Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës së mësipërme, bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*

V E N D O S I:

16 Vota Pro

0 Kundra

0 Abstenim

Të miratojë numrin e punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi, njësive administrative dhe klasifikimi i pagave të administratës dhe punonjësve të tjerë për vitin 2026, Bashkia Has.

Numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Has të jetë 307 punonjës, i ndarë si më poshtë:

1. Në Bashkinë Qendër: **141 punonjës**
2. Në Njësinë Administrative Golaj: **33 punonjës**
3. Në Njësinë Administrative Fajza: **25 punonjës**
4. Në Njësinë Administrative Gjinaj: **14 punonjës**
5. Funksionet e Deleguara: **91 punonjës**
6. Punonjës nga Funksionet e Deleguara (Gjendja Civile): **3 punonjës**
7. Punonjës Sezonal (mbi organikë): **25 punonjës**
8. 15 vende pune me kohë të pjesshme (punonjës me orë pune jo më shumë se 42 orë në muaj).

A) KLASIFIKIMIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË PËR VITIN 2026, BËHEN SI MË POSHTË:

1. Paga për pozicion **"Kryetar i Bashkisë Has"** të jetë në nivelin **240,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.1, pika ç,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
2. Paga për pozicion **"Zv.Kryetar i Bashkisë Has"** të jetë në nivelin **185,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.1, pika ç,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
3. Paga për pozicion **"Sekretar i Përgjithshëm"** të jetë në nivelin **170,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** kategoria **I,** klasa **I-5,**VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**

4. Paga për pozicion **"Sekretar i Këshillit Bashkiak"** të jetë në nivelin **141,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** klasa **II-2,** kategoria **II,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
5. Paga për pozicion **"Drejtor Drejtorie"** të jetë në nivelin **141,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** kategoria **II,** klasa **II-2,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
6. Paga për pozicion **"Administrator NJA/Golaj",** të jetë në nivelin **145,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.8,** pika **nr.3,** VKM **nr.503,** datë **01.08. 2024.**
7. Paga për pozicionin **"Administrator në NJA/Fajza, dhe NJA/Gjinaj",** të jetë në nivelin **140,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.8,** pika **4,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
8. Paga për pozicion **"Këshilltare e Kryetarit të Bashkisë Has",** të jetë në nivelin **105,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** klasa **III-2,** kategoria **III,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
9. Paga për pozicionin **"Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor"** të jetë në nivelin **105,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** klasa **III-2,** kategoria **III,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
10. Pika **12** ngelet e pandryshuar, sipas VKM **nr. 328,** datë **31.05.2023** pika **11.**

Paga për pozicionin **"Përgjegjës Sektori që nuk kanë arsim të lartë"**, paga për funksion të jetë në nivelin **47,000 lekë.**

11. Paga për pozicionin **"Specialist/Inspektor",** të jetë në nivelin **67,200 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** kategoria **IV,** klasa **IV-3,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
12. Paga për pozicion **"Sekretare/Arsimi i Mesëm",** të jetë në nivelin **58,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** kategoria **IV,** klasa **IV-4,**VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**
13. Paga për pozicion **"Punonjës Pyjesh/Inspektor Pyjesh",** me arsim të mesëm pyjor të jetë në nivelin **46,700 lekë,** sipas VKM **nr.113,** datë **01.03.2023,** *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".*
14. Paga për pozicionin **"Kryeinspektor i Policisë Bashkiake",** të jetë në nivelin **65,200 lekë,** bazuar në VKM **nr.625** datë **28.9.2022,** lidhja **nr.8.**
15. Paga për pozicion **"Inspektor i Policisë Bashkiake",** të jetë në nivelin **51,000 lekë,** bazuar në VKM-në **nr.625** datë **28.09.2022,** lidhja **nr.8.**
16. Paga për pozicion **"Punonjës i Policisë Bashkiake",** të jetë në nivelin **46,000 lekë,** bazuar në VKM **nr.625** datë **28.09.2022,** lidhja **nr.8.**
17. **Këshilltarët e Këshillit të Bashkisë Has,** bazuar në ligjin **nr.139/2015, neni 51, pika 1,** *"Për Vetëqeverisjen Vendore",* shpërblimi mujor të jetë në masën **10%** e pagës së Kryetarit të Bashkisë.

18. Vlera e pagës së grupit, për çdo nivel të studimeve universitare, përcakohen në lidhjen **nr.9,** VKM **nr.503** datë **01.08.2024.**

Grupi i diplomës	**Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)**	**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)**
1	Niveli 7 i KSHK	**14, 000**

	(Master i Shkencave. Master i Arteve. "Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike". Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**12, 000**
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**10, 000**

18/1. Shtesë mbi pagë për punonjësit e TIK = **5000 lekë,** sipas VKM **nr.328,** datë **31.5.2023.**

18/2. Shtesa për vjetërsi në punë sipas VKM **nr.503,** datë **01.08.2024**, të jepet në masën:

i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, **"vite pune"** do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, më përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete të koeficientit të përllogaritjes së vjetërsisë:

Vite	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
%	0	0.6	1.2	1.8	2.4	3	3.6	4.2	4.8	5.4	6

Vite	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
%	6.8	7.6	8.4	9.2	10	10.8	11.6	12.4	13.2	14

Vite	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
%	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24

19. Në mbështetje të VKM **nr.113,** datë **01.03.2023,** *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, për pozicionet e listuara më poshtë, klasifikimi i pagave do të jetë si më poshtë:

Pastrues me Fshesë në Hapësirat Publike	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës dhe Roje Varrezash	**40, 000 lekë**
Punëtor Gjelbërimi	**40, 000 lekë**
Punonjës Gjelbërimi dhe Menaxhim i Mbetjeve	**40, 000 lekë**
Pastruese (Tregu, Institucioni, Hapësira Publike)	**40, 000 lekë**
Shofer Kamioni, Ngarkim, Shkarkim, Transport i Mbetjeve Urbane	**40, 000 lekë**
Roje Hapësira Publike dhe Pemë Dekorative	**40, 000 lekë**
Roje Tregu, Institucioni, Hapësira Publike	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës i Mjeteve dhe Kaldajave	**40, 000 lekë**
Punëtor, Mirëmbajtës KUZ/KUB	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës Objektesh (Bojaxhi, Marangoz, Murator)	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës Objektesh Ndërtimore NJA/Golaj, NJA/Fajza	**40, 000 lekë**
Dezhurn (Recepsionist)	**40, 000 lekë**
Shofer i Mjeteve të Rënda	**40, 000 lekë**
Roje Objekti (ditë, natë)	**40, 000 lekë**
Roje Objekti NJA/Golaj	**40, 000 lekë**
Roje Objekti, Sanitar NJA/Fajza	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës Rrjeti (Hidraulikë, Elektrikë, Telefonikë)	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës i Rrugëve Rurale	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës Ujësjellësi	**40, 000 lekë**
Punëtor Ngarkim, Shkarkim (transport mbeturinash, mbetje urbane)	**40, 000 lekë**

Roje dhe Mirëmbajtës Thërtoreje	**40, 000 lekë**
Trajner Futboll	**40, 000 lekë**
Inspektor Sporti	**40, 000 lekë**
Kaldaist, Roje pa Armë	**40, 000 lekë**
Roje Pylli, Roje Pylli (vrojtues zjarresh)	**40, 000 lekë**
Punonjës, Mirëmbajtës Ujësjellësi Komunal	**40, 000 lekë**
Mirëmbajtës Rrugë Rurale dhe Ujësjellësi/NJA Gjinaj	**40, 000 lekë**
Sanitare Shkolle	**40, 000 lekë**
Sanitare Kopshti	**40, 000 lekë**
Sanitare Institucioni	**40, 000 lekë**
Magazinier	**40, 000 lekë**

20. **Përgjegjës në Konviktin "Kosova"** Krumë, paga të jetë në nivelin **105,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** klasa **III-2,** kategoria **III,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**

21. **Edukator, Kujdestar Konvikti, "Kosova",** Krumë, paga të jetë në nivelin **58,000 lekë**, sipas lidhjes **nr.3,** pika **7,**VKM **nr. 425,** datë **26.6.2024.**

22. **Punonjës në konviktin "Kosova" Krumë,** paga të jetë në nivelin **40,000 lekë,** bazuar në VKM **nr.113,** datë **01.03.2023,** *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"*, për pozicionet e listuara si më poshtë:

Magazinier	**40, 000 lekë**
Kuzhinier	**40, 000 lekë**
Ndihmëse Kuzhiniere/Pjatalarëse	**40, 000 lekë**
Pjatalarëse	**40, 000 lekë**
Rrobalarëse	**40, 000 lekë**
Sanitare	**40, 000 lekë**
Kaldaist/Roje pa Armë	**40, 000 lekë**
Roje pa Armë	**40, 000 lekë**

23. Në mbështetje të Urdhërit nr.199, datë 02.05.2017 të Bashkisë Has, *"Për dhënien e vështirësisë së punonjësve sanitarë në arsimin parashkollor dhe të mesëm"*, shtesa e pagës për vështirësi do të jetë në masën **5, 340 lekë.**

B) KLASIFIKIMI I PAGAVE PËR FUNKSIONET E DELEGUARA

Arsim Parashkollor dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve (QKF), bazuar në VKM nr.425, datë 26.6.2024, paga do të jetë:

1. Përgjegjës Sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, paga për pozicion do të jetë në nivelin **73,000 lekë,** sipas VKM **nr. 425,** lidhja **nr.3,** pika **5,** datë **26.6.2024.**

2. Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, paga për pozicion do të jetë në nivelin **60,000 lekë,** sipas VKM **nr. 425,** lidhja **nr.3, pika 6,** datë **26.6.2024.**

3. Drejtor i kopshti pa ushqim, paga për pozicion do të jetë në nivelin **75,000 lekë,** sipas VKM **nr. 425,** lidhja **nr.3, pika 4,** datë **26.6.2024.**

4. Edukator/e në Kopsht Fëmijësh, paga për pozicion do të jetë në nivelin **58,000 lekë,** sipas VKM **nr. 425,** lidhja **nr.3,** pika **8,** datë **26.6.2024.**

5. Edukatore/Kujdestare në Çerdhe (me arsim të lartë), paga për pozicion të jetë në nivelin **58,000 lekë,** sipas VKM **nr. 425,** lidhja **nr.3,** pika **8,** datë **26.6.2024.**

6. Përgjegjës në Çerdhe, paga për pozicion të jetë në nivelin **70,000 lekë,** sipas lidhjes **nr.6,** klasa **III-2,** kategoria **III,** VKM **nr.503,** datë **01.08.2024.**

7. Edukatore/Kujdestare në Çerdhe (me arsim të mesëm), paga të jetë në nivelin **47,000 lekë,** sipas VKM, nr.**328** datë **31.05.2024.**

8. Punonjës QKF që nuk kanë arsim të lartë, paga të jetë në nivelin e pagës minimale **40,000 lekë,** bazuar në VKM **nr.113,** datë **1.3.2023.**

a) Shtesa për vjetërsi në punë, VKM nr.425, datë 26.6.2024, të jepet në masën:

i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, **"vite pune"** do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, më përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Vite	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
%	0	0.6	1.2	1.8	2.4	3	3.6	4.2	4.8	5.4	6

Vite	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
%	6.8	7.6	8.4	9.2	10	10.8	11.6	12.4	13.2	14

Vite	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30
%	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24

b) Shtesa për kategorinë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit, do të llogaritet në përqindje, për çdo kategori, si më poshtë vijon:

- 10 (dhjetë) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë *"mësues i kualifikuar";*
- 20 (njëzet) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë *"mësues specialist";*
- 30 (tridhjetë) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë *"mësues mjeshtër";*

Masa në përqindje, sipas përcaktimeve të mësipërme, llogaritet mbi vlerën e përcaktuar në lidhjen nr.4, të këtij vendimi, për grupin përkatës të diplomës, referuar nivelit më të lartë të kualifikimit, që zotërojnë punonjësi mësimor.

Punonjësit mësimor, të cilët punojnë largë vendbanimit, përfitojnë një kompensim në masën, si më poshtë vijon: kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, mbi **5** (pesë) kilometra largë vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është **2, 700 lekë** (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj.

Kompensimi për largësi nga vendbanimi nuk aplikohet për periudhën gjatë së cilës punonjësi mësimor kryen pushimet vjetore të pagueshme.

c) Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome për punonjësit mësimor sipas lidhjes nr. **4,** VKM **nr. 425, datë 26.6.2024.**

Grupi i diplomës	**Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve**	**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)**
1	Niveli 7 i KSHK (Master i Shkencave. Master i Arteve. Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**14,000**
2	Niveli 7 i KSHK (Master Profesional. Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**12,000**

3	Niveli 6 i KSHK (Bachelor. Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**10,000**
4	"Diplomë e maturës shtetërore", të shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli "Mësues i shkollës fillore". "Diplomë e maturës shtetërore", të shkollës së mesme profesionale, për të cilat fitohet specialiteti për mësuesi. Diplomë e maturës shtetërore të shkollave me drejtim të orientuar. Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomat jouniversitare profesionale 2-vjeçare. Diplomë e shkollës së mesme profesionale	**8,000**

C) MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILËN ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, sipas VKM nr.419, datë 26.6.2024.

a) Strukutura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, sipas VKM-së nr.419, datë 26.6.2024, lidhja nr.1:

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
Niveli bazë	Asistent Zjarrfikës	**60,000**	**7,000**
	Zjarrfikës	**65,000**	**8,000**
	Kryezjarrfikës	**70,000**	**8,000**
Niveli i mesëm	Inspektor Zjarrfikës	**75,000**	**6,000**
	Kryeinspektor Zjarrfikës	**85,000**	**6,000**
	Komisar Zjarrfikës	**105,000**	**6,000**
Niveli i lartë	Drejtues Zjarrfikës	**115,000**	**6,000**
	Drejtues i Parë Zjarrfikës	**140,000**	**6,000**
Niveli madhor	Drejtues i Lartë Zjarrfikës	**160,000**	**6,000**

b) Shtesa për vjetërsi shërbimi, që është shtesa që përfiton punonjësi i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për çdo vit vjetërsi në shërbim, në masën 1 (një) % për çdo vit, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës "asistent zjarrfikës".
c) Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi, *"vite shërbimi"*, do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të çdo punonjësi, në strukturën e Shërbimit të Mbrojtes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Policisë së Burgjeve, të Gradës së Republikës së Shqipërisë, të Agjensisë së Mbikëqyrjes Policore, të Policisë së Shtetit, si dhe në strukturën e Shërbimit Informativ të Shtetit.
d) Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

D) BORDI I KULLIMIT, sipas VKM **nr.421,** datë **26.6.2024,** për disa shtesa dhe ndryshime në VKM **nr. 325,** datë **31.5.2023,** klasifikimi i pagave të jetë si më poshtë:

1) **Përgjegjës/Bordi i Kullimit,** paga për funksion të jetë në nivelin **105,000 lekë,** sipas VKM **nr.421,** lidhja **nr.1** kategoria **III,** klasa **III-2,** datë **26.6.2024.**
2) **Specialist i Bordit të Kullimit, (i deleguar),** paga për funksion të jetë në nivelin **67,200 lekë,** sipas VKM-së **nr.421,** lidhja **nr.1,** kategoria **IV,** klasa **IV-3,** datë **26.6.2024.**
3) **Shofer i Mjeteve të Rënda, Manovrator (i deleguar),** paga për funksiontë jetë në nivelin **40,000 lekë,** sipasVKM **nr.113,** datë 01.03.2024 *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".*
4) **Punonjës i Bordit të Kullimit,** paga për funksion të jetë në nivelin **40,000 lekë,** sipas VKM **nr.113,** datë 01.03.2024, *"Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".*

Grupi i diplomës	**Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)**	**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)**
1	Niveli 7 i KSHK (Master i Shkencave. Master i Arteve.	**14, 000**

	"Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike". Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**12, 000**
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**10, 000**

E) **GJENDJA CIVILE,** sipas VKM **nr.421,** datë **26.6.2024,** klasifikimi i pagave të jetë si më poshtë:

1) **Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile në Bashki** (si funksion i deleguar), klasa **III-3,** VKM nr.**421,** datë **26.6.2024,** paga për funksion të jetë në nivelin **98,000 lekë.**
2) **Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile NJA/Golaj dhe Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile NJA/Fajza,** klasa **IV-1,** VKM **nr.421,** datë **26.6.2024,** paga për funksion të jetë në nivilin **90,000 lekë.**

Grupi i diplomës	**Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)**	**Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)**
1	Niveli 7 i KSHK (Master i Shkencave. Master i Arteve. "Master Profesional të përfituar në fund të	**14, 000**

	studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike". Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**12, 000**
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	**10, 000**

24. Kryetarët e fshatrave, bazuar në ligjin **nr.139/2015,** neni **71** pika **6,** *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, VKM **nr.165,** datë **02.03.2016** pika **16,** *"Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore"* Këshillat e njësive të qeverisjes vendore, bazuar në numrin e banorëve të fshatit, miratojnë shpërblimin mujor të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 % të pagës së:

a) Administratorëve të Njësive Administrative, kur fshati është pjesë e njësisë administrative, sipas kufijve të pagave të administratorëve, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Kryetarëve të bashkive, kur fshati bën pjesë në Njësitë Administrative ku ndodhet qendra e bashkisë, sipas kufijve të pagave të përcaktuara për kryetarët e bashkive, në pikën 1 të këtij vendimi.

❖ **<u>Bashkia Has, Qendër</u>**

Kryetari i Fshatit Krumë	**10 %** e pagës së Kryetarit të Bashkisë Has
Kryetari i Fshatit Zahrisht	**9 %** e pagës së Kryetarit të Bashkisë Has
Kryetari i Fshatit Gajrep	**9%** e pagës së Kryetarit të Bashkisë Has
Kryetar i Fshatit Mujaj	**8%** e pagës së Kryetarit të Bashkisë Has
Kryetari i Fshatit Cahan	**7%** e pagës së Kryetarit të Bashkisë Has

❖ **Njësia Administrative Golaj**

a) **Kryetarët e Fshatrave:** Golaj, Nikoliq,Vlahen, Helshan, Letaj shpërblimi mujor do të jetë në masën **10%** e Pagës së Administratorit të Njësisë Administrative Golaj.

b) **Kryetarët e Fshatrave:** Qarr, Peraj, Zgjeq, Kosturr, Bardhaj, Perollaj, Dobrunë, shpërblimi mujor do jetë në masën **9%** të pagës së Administratorit të Njësisë Administrative Golaj.

❖ **Njësia Administrative Fajza**

a) **Kryetarët e Fshatrave:** Fajza, Brenogë, Sefoll, Liqe Kuq, Tobël, shpërblimi mujor do të jetë në masën **9%** të pagës së Administratorit të Njësisë Administrative Fajza.

b) **Kryetarët e Fshatrave:** Vranisht, Tregtan dhe Metaliaj shpërblimi mujor do të jetë në masën **10 %** të pagës së Administratorit të Njësisë Administrative.

❖ **Njësia Administrative Gjinaj**

a) **Kryetari i Fshatit** Gjinaj shpërblimi mujor do të jetë në masën **10 %** të pagës së Administratorit të Njësisë Administrative Gjinaj .

b) **Kryetarët e Fshatrave:** Kishaj, Pus i Thatë, Myç-Has, Domaj dhe Pogaj shpërblimi mujor do të jetë në masën **9 %** të pagës së Administratorit të Njësisë Administrative Gjinaj.

Ngarkohen sektorët përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ISUF SEFOLLI

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,Tel/Fax.: +355 214 22080, e-mail:info@bashkiahas.gov.al